

213/14
05/01/2022

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
PËR BASHKËPUNIM
NDËRMJET
BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË
DHE
BIBLIOTEKËS KOMBËTARE "ST. CYRIL AND
METHODIUS" TË REPUBLIKËS SË BULLGARISË**

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë në Sheshin "Skënderbej", Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Piro Misha, Drejtor,

dhe

Biblioteka Kombëtare "St. Cyril and Methodius" e Bullgarisë në Rr. 88 Vasil Levski Blvd., 1504 Sofje, Bullgari, përfaqësuar nga Prof. Assoc. Krasimira Aleksandrova, Drejtor,

(në tekstin e mëposhtëm "Palët") duke synuar nxitjen e formave ekzistuese të shkëmbimit kulturor dhe vendosjen e formave të reja të bashkëpunimit të drejtpërdrejtë në fushën e bibliotekave dhe fushave të lidhura me to, bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Fushat e bashkëpunimit

Referuar ligjit ekzistues të dy Palëve dhe dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi (në tekstin e mëposhtëm referuar si "MM"), Palët bien dakord të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta në fushat e bashkëpunimit me interes të përbashkët, të identifikuar si më poshtë:

1.1 Palët bien dakord të shkëmbejnë dokumente dhe materiale bibliotekare që i nënshtrohen kritereve të paracaktuara të dakorduara ndërmjet palëve. Bibliotekat do të marrin përsipër të japin informacion mbi rezultatet e këtij shkëmbimi dokumentesh në fund të çdo viti kalendarik.

1.2 Huazimet ndërbibliotekare ndërmjet Palëve do të bëhen në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi në të dyja vendet dhe referuar praktikës ekzistuese ndërkombëtare.

1.3. Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e specialistëve të bibliotekës. Termat dhe kushtet për çdo vizitë të veçantë të ekspertëve të bibliotekës do të përcaktohen me marrëveshje të ndërsjellë të pasqyruar me shkrim në një aneks që është pjesë e këtij ligji.

1.4 Palët bien dakord të promovojnë bashkëpunimin në fushën e bibliotekonomisë, bibliografisë, informacionit shkencor, koleksioneve të dorëshkrimeve.

1.5 Palët mund të shkëmbejnë ekspozita dhe të marrin pjesë në projekte të përbashkëta bazuar në një aneks dypalësh të veçantë në këtë MM.

Neni 2

Procedura për Zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit

2.1 Secila palë do të caktojë pika kontakti që do të shërbejnë si përfaqësues të institucionit për koordinimin dhe kontrollin e zbatimit të kontratës.

2.2 Palët do të bien dakord reciprokisht për formën, kushtet dhe detajet për zbatimin e secilit aktivitet të veçantë që do të kryhet si pjesë e iniciativave të përshkuara në nenet e mësipërme.

2.3 Aktivitetet sipas këtij MM do të kryhen në përputhje me legjislacionin e brendshëm të secilës prej Palëve.

2.4 Detyrimet e Palëve duke përfshirë detyrimet financiare që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe ekzekutimin e aktiviteteve sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të përcaktohen nëpërmjet konsultimeve të ndërsjella dhe do të bien dakord me shkrim nga Palët.

2.5 Shpenzimet, që mund të lindin në lidhje me aktivitetet e përmendura, do të jenë pjesë e kufizimit fiskal dhe kapacitetit buxhetor të secilës Palë.

2.6 Kjo Marrëveshje nuk do të krijojë baza për shfaqjen e ndonjë detyrimi financiar ose detyrimi pronësor, as nuk do të përbëjë bazë që Palët të zhvillojnë pretendime reciproke kundër njëra-tjetrës.

Neni 3

Kohëzgjatja

3.1. Ky MM do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë prej dy (2) vitesh.

3.2 Secila Palë mund ta përfundojë këtë memorandum duke i paraqitur njoftim me shkrim (1) muaj para palës tjetër.

3.3. Në rast të përfundimit ose ndërprerjes së këtij Memorandumi Mirëkuptimi, klauzolat dhe dispozitat e kontratës do të mbeten në fuqi në lidhje me çdo angazhim të pazgjidhur, detyrë dhe marrëveshje të bëra tashmë midis Palëve.

Neni 4

Dispozitat përfundimtare

4.1 Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes negociatave dhe konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve dhe nëpërmjet kanaleve diplomatike.

4.2. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet, plotësohet ose rishikohet vetëm me marrëveshje reciproke me shkrim të palëve të pasqyruara në anekset e nënshkruara nga përfaqësuesit ligjorë të palëve.


Ky MM është nënshkruar në dy kopje në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze. Në rast mospërputhje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të prevalojë.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë



Z. Piro Misha
Drejtor

Biblioteka Kombëtare "St. Cyril and Methodius"



Assoc. Prof. Krasimira Aleksandrova
Profesor